



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Shkurt 2021

Nr: 47

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE NR.38, DATË 17.12.2020 “PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT
PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR KUVEND,
TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 144, paragrafi 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Referuar nenit 29, paragrafi 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Masa e shpërblimit për anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, rishikohet sipas fondeve buxhetore të miratuara me ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 144, paragrafi 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,



VENDOS:

1. Në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.38, datë 17 dhjetor 2020 “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”, paragrafi 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Të caktojë masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021:

- a) Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 - b) Anëtari dhe Sekretari i KZAZ-së në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
 - c) Kryetari i KQV-së në vlerën 4.000 (katërmijë) lekë.
 - ç) Anëtari dhe Sekretari i KQV-së në vlerën 3.500 (tremijë e pesëqind) lekë.
 - d) Anëtari i GNV-së në vlerën 6.000 (gjashtëmijë) lekë.”
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

